1. *Deklarata:* Ju lutemi që me vëmendje plotësoni saktësisht çdo pjesë të deklaratës. Nëse e dërgoni personalisht kolegët tanë i kontrollojnë të dhënat, por nëse e dërgoni me postë kjo gjë nuk është e mundur, prandaj ju lutemi që me një vëmendje të madhe kontrolloni të dhënat tuaja, sepse në rast gabimi sistemi i uljes së çmimeve nuk hyn në fuqi.

2. *Blerja:* Gjatë blerjes sistemi i ofron shumën maksimale të uljes atyre që e plotësojnë deklaratën. Blerja do të thotë përdorimin e uljes së çmimeve ose pagesën e bonusave, kështu edhe blerja personale kërkon letërnjoftim me fotografi. Në rastin e blerjes si grup duhet të sillni autorizim të nënshkruar nga dy dëshmitarë të rregullt nga çdo person, për çdo porosi. Kolegët tanë i pranojnë porositë vetëm pasi i kanë kontrolluar këto gjëra. Në rastin e personave me deklaratë mungesa e letërnjoftimit apo e autorizimit sjell refuzimin e porosisë!

3. *Informimi:* Kolegët tanë nëpër magazina vetëm pas paraqitjes së letërnjoftimit me fotografi dhe dorëzimit të autorizimeve japin informacione rreth shumës aktuale të uljes.

Zyra e Debrecenit

Bashkëpunonjësit me deklaratë dhe që i marrin bonusat e tyre në formë kuponash, mund të informohen rreth shumave të sakta në adresën Budapest, Szondi u. 34.
Dëshiroj t'ju thërras vëmendjen distributorëve të Hungarisë për shërbimin tonë të transportimit të pakove. Me anë të këtij shërbimi Distributori tanë të nderuar i marrin porositë e bëra maksimum brenda 2 ditëve – me përputhje kohe – në çdo pikë të vendit, të cilat duhen marrë brenda 48 orëve, pasi në rast të kundërt ato i anullojmë dhe pikët i zbrisim. Çmimi i produkteve të porositura dhe ai i transportit duhet paguar kur pakoja merret në dorë. Në rastin e blerjes me vlerë mbi 1 pikë shpenzimet e transportit paguhen nga kompania. Porositë tuaja mund t'i bëni në mënyrën e mëposhtme:
– në telefon, ku punonjësi ynë ju jep informacione të sakta rreth shumës së porosisë, vlerës së saj në pikë dhe çmimit të transportit.
Numrat e telefonit: 061-297-5538, 061-297-5539, cel: 0620/456-8141, 0620/456-8149
– nëpërmjet internetit në adresën www.flpshop.hu,
– me sms në numrin e telefonit 0620-478-4732.

Çmimet e transportit:

Budapest	Provincë	
0-5 kg	640 Ft	1260 Ft
5-10 kg	1240 Ft	1720 Ft
10-30 kg	1520 Ft	1940 Ft
Mbi 30 kg	30 Ft/kg	30 Ft/kg

- Çmimet e mësipërme janë të vlefshme deri në 3 porosi/adresë, mbi 3 porosi llogarisim +200 Ft/porosi.
- Çmimi i postimit është 360 Ft/adresë.
- Siguracioni: deri në shumën 200 000 Ft e përmban çmimi i transportit, mbi këtë shumë për çdo 10 000 Ft është 50 Ft.
- Çmimet e mësipërme nuk përmbajnë TVSH-në prej 20%.
- Transportimi i porositve bëhet pas përputhjes paraprake në telefon. Shpenzimet e përputhjes në telefon përmbahen nga çmimet e mësipërme.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Hungarisë:

- Dr. Gabriella Kassai: +36-30-307-7426
- Dr. György Bakanek: +36-20-944-1442
- Dr. Laszlo Kerekes: +36-20-944-1442
- Dr. László Mezôsi, veteriner: +36-20-552-6792

Të nderuar bashkëpunonjës!

U njoftojmë me kënaqësi se edhe sivjet shfaqim programin dobësues "Clean 9 dhe Lifestile 30". Gjatë periudhës së programit mund të paraqiteni dy herë në zyrat tonë për matjen e peshës, dhe në raport me uljen në përqindje të peshës dalin fituesit e çdo kategorie.

Programi "Clean 9 dhe Lifestile 30" zgjat nga 1 prilli deri më 30 qershor. Shkoni të mateni në zyrat tona. Të çlirohemi nga kilet e tepërta me paketën e produkteve Clean 9 dhe Lifestile 30! Qëllimi është peshë më e shëndetshme dhe shpërblimet me vlerë!



NJOFTIMET E ZYRAVE TË SERBISË

- Zyra e Beogradit: 11000 Beograd, Kumodraska 162, tel.: +381-11-3970-127.
- Zyra e Nisit: 18000 Niš, Učitelj Tasina 13/1., tel.: +381-18-514-130, +381-18-514-131. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 11.00-19.00, në ditët e tjera të punës 9.00-17.00.
- Zyra e Horgosit: 24410 Horgoš, Rade Končara 80. tel.: +381-24-792-195. Drejtori i rajonit: Branislav Rajic.
- Forever Living Products Beograd na ofron shërbimet e mëposhtme: bërje porosish në telefon - Telecenter. Numri i telefonit: 011/309-6382. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12:00-19.30, në ditët e tjera të punës 9:00-16.30. Në rastin e porositjes në telefon malli shkon tek adresa që gjendet në numrin e kodit dhe paguhet kur merret në dorë.
- Shpenzimet e postës paguhen sipas kursit të PTT Serbisë të ditës

- që ndodh shërbimi, por FLP-ja e Beogradit i paguan vetëm nëse porosia e bërë në një numër kodi e kalon 1 pikë krediti.
- Nuk mund të bëhet hyrje nëpërmjet telefonit.
- Porositë telefonike merren në shqyrtim deri në datën 25 të muajit, pas kësaj date mund të porosisni vetëm personalisht në zyrën tonë.
- Edhe në zyrën e Horgosit dhe Nisit mund të blihen materiale reklamash dhe gjithë llojet e formularëve. Distributorët tanë mund të blejnë edhe fletat e regjistrimit dhe formularët për ndryshimin e të dhënave.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Serbisë:

- Dr. Biserka Lazarević dhe Dr. Predrag Lazarević: +381-23-543-318



NJOFTIMET E ZYRËS SË MALIT TË ZI

- 81000 Podgorica, Serdara Jola Piletića br: 20. tel: +381-081-245-402, tel/fax: +381-081-245-412. Drejtori i rajonit: Aleksandar Dakic

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Malit të Zi:

- Dr. Laban Nevenka: +381-69-327-127



NJOFTIMET E ZYRAVE TË BOSNIA-HERCEGOVINËS



Zyra e Bijelinës

- Zyra e Bijelinës: 76300 Bijeljina, Trg Đenerala Draže Mihajlovića br. 3., tel: +387-55-211-784, +387-55-212-605, fax: +387-55-221-780. Orari i hapjes në ditët e punës: 9.00-17.00.
- Zyra e Banja Lukas: 78 000 Banja Luka, Duško Koščica u. 22., tel.: +387-51-228-280, fax: +387-51-228-288. Drejtori i rajonit: Dr. Slavko Paleksic. Orari i hapjes: në ditët e punës 9.00-16.30
- Zyra e Sarajevës: 71000 Sarajevo, Akifa Seremeta do. 10., tel.: +387-33-760-650, +387-33-470-682, fax: +387-33-760-651.. Orari i hapjes: të hënën, të enjten, të premten: 09.00-16.30, të martën, të mërkurën: 12.00-20.00. Në çdo të shtunë të fundit të muajit organizojmë një Ditë Suksesi Mini në zyrën e FLP-s. Drejtori i rajonit: Enra Hadžović Në zyrat e Forever Living Products të Bosnias porositë telefonike mund të bëhen në numrat e mëposhtëm (regjistrimi i shpërndarësve të rinj nuk mund të bëhet nëpërmjet telefonit): +387-55-211-784.

Njoftim i zyrës së FLP-s së Sarajevës

- Nga shtatori në shërbimin tonë është këshilltarja dhe specialistja mjekje nga Bosnia-Hercegovina Dr. Esmā Nisic, me të cilën mund të kontaktohem në numrin e telefonit: +387-62-367-545 gjatë ditëve të punës në orarin: 18:00 – 21:00.

– Këshilltarja dhe specialistja jonë mjekje çdo të mërkurë mban konsultime në zyrën e Sarajevës në orën 17:00 – 19:30.
– Në rastin e porosisë telefonike pagesa bëhet kur merret malli. Nëse vlera e porosisë është më e madhe se 1 pikë krediti, atëherë shpenzimet e transportit paguhen nga distributori.



NJOFTIMET E ZYRAVE TË KROACISË

- Zyra e Zagrebit: 10000 Zagreb, Grada Mainza 21., tel.: +385-1-390-9770., fax: +385-1-3909-771. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00; të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00.
- Zyra e Splitit: 21000 Split, Križine 19. tel.: +385-21-459-262. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00; të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00. Drejtori i rajonit: Dr. Molnár László

– Porosia telefonike bëhet në numrin +385-1-3909-773. Nëse vlera e porosisë është më e madhe se 1 pikë, shpenzimet e transportit i paguan FLP-ja.
– Leksionet rreth marketingut dhe produkteve fillojnë çdo të hënë dhe të enjte në orën 18.00 në zyrën qendrore.

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Kroacisë:

Dr. Ljuba Rauski Naglic: +385-915176510
Dr. Eugenija Sojat Marendic: +385-915107070



NJOFTIMET E ZYRAVE TË SLOVENISË

- 1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 5., tel: +386-1-562-3640. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00, të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00.
- Adresa e magazinës së Lendavait: Kolodvorska 14., 9220 Lendava. tel: +386-2-575-1270. Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00, të martën dhe të premten 09.00-17.00. Drejtori i rajonit: Kepe Andrej

Numri i Telecenterit (ku bëhen porositë telefonike) është: 01/563-7501

Numrat e telefonit të specialistëve tanë mjek të Sllovenisë:

Dr. Arbaiter Miran: +386-41420788
Dr. Canzek Olga: +386-41824163



Zyra e Lendvait



NJOFTIMET E ZYRËS SË KOSOVËS

• Prishtinë, Rr. Zagrebi PN, tel.: +381-38-240-781. Drejtori i rajonit: Lulzim Tytynxhii

www.flpseeu.com FLP TV në internet

Programi nga 30 mars deri më 25 maj 2007

10.00 Lajme	14.30 Success Day – Koncert i Fresh-it	21.30 World Rally 2007	03.35 Rruga – Zsolt Fekete
5.05 Nga bima deri tek produkti	14.50 Success Day – Istvan Halmi – Si të kesh një natë pa gjumë	Forever Pomesteen – Film prezantues produktesh	03.55 Pro6 - Film prezantues produktesh
10.20 Success Day – Dr. György Bakanek – Fëmijë të shëndetshëm	15.10 Success Day – Kualifikimet e managerëve, janar 2007	21.35 Salloni Sonya – hapja	04.00 FLP – Plani Marketing
10.40 Nature's 18, Aloe2Go – Film prezantues produktesh	14.40 Film prezantues produktesh – Probiotic	21.40 Success Day – Dr. Adolf L. Kosa – Përse?	04.20 Success Day – Dr. Erika Tanacs Tombaczne – Pënjeto Momentin
10.45 Success Day – Kualifikimet e managerëve, janar 2007	15.50 Michael Strachowitz – Ndërtim rrethi me sukses në FLP	22.00 Active HA – Film prezantues produktesh	04.40 Success Day – Koncert i Magdolna Ruzsa-s
11.20 FLP-ja prej 25 vitesh	17.50 Salloni Sonya – hapja	22.05 Success Day – Dr. Edit Revesz Siklosne – Ngarkohu me Pomesteen	05.10 Dita e kozmetikës Sonya – përmbledhje
11.35 Rruga – Zsolt Fekete	18.00 Lajme	22.30 Success Day – Koncert i Fresh-it	05.30 World Rally 2007
11.55 Pro6 – Film prezantues produktesh	18.05 Nga bima deri tek produkti	22.50 Success Day – Istvan Halmi – Si të kesh një natë pa gjumë	05.35 Forever Pomesteen – Film prezantues produktesh
12.00 FLP – Plani Marketing	18.20 Success Day – Dr. György Bakanek – Fëmijë të shëndetshëm	23.10 Success Day – Kualifikimet e managerëve, janar 2007	05.40 Success Day – Dr. Adolf L. Kosa – Përse?
12.20 Success Day – Dr. Erika Tanacs Tombaczne – Pënjeto Momentin	18.40 Nature's 18, Aloe2Go – Film prezantues produktesh	23.40 Film prezantues produktesh – Probiotic	06.00 Active HA – Film prezantues produktesh
12.40 Success Day – Koncert i Magdolna Ruzsa-s	18.45 Success Day – Kualifikimet e managerëve, janar 2007	00.50 Michael Strachowitz – Ndërtim rrethi me sukses në FLP	06.05 Success Day – Dr. Edit Revesz Siklosne – Ngarkohu me Pomesteen
13.10 Dita e kozmetikës Sonya – përmbledhje	19.20 FLP-ja prej 25 vitesh	01.50 Salloni Sonya – hapja	06.30 Success Day – Koncert i Fresh-it
13.30 World Rally 2007	19.35 Rruga – Zsolt Fekete	02.00 Lajme	06.50 Success Day – Istvan Halmi – Si të kesh një natë pa gjumë
Forever Pomesteen – Film prezantues produktesh	19.55 Pro6 – Film prezantues produktesh	02.20 Success Day – Dr. György Bakanek – Fëmijë të shëndetshëm	07.10 Success Day – Kualifikimet e managerëve, janar 2007
Salloni Sonya – hapja	20.00 FLP – Plani Marketing	02.40 Nature's 18, Aloe2Go – Film prezantues produktesh	07.40 Film prezantues produktesh – Probiotic
13.40 Success Day – Dr. Adolf L. Kosa – Përse?	20.20 Success Day – Dr. Erika Tanacs Tombaczne – Pënjeto Momentin	02.45 Success Day – Kualifikimet e managerëve, janar 2007	08.50 Michael Strachowitz – Ndërtim rrethi me sukses në FLP
14.00 Active HA – Film prezantues produktesh	20.40 Success Day – Koncert i Magdolna Ruzsa-s	03.20 FLP-ja prej 25 vitesh	09.50 Salloni Sonya – hapja
14.05 Success Day – Dr. Edit Revesz Siklosne – Ngarkohu me Pomesteen	21.10 Dita e kozmetikës Sonya – përmbledhje		



TRASHËGIMIA

■ Dr. Terezia Samu dhe Andras Bruckner

Gyuri! Dëgjon?! Ti ishte për ne GYURI! Një koncept, një njeri i veçantë, të cilit i kushtonim vëmendje, të cilin e dëgjonim, mendimi i të cilit kishte vlerë. Kështu të donim dhe të respektonim bashkë me dobësitë e tua njerëzore. Derisa ishte këtu, ishte e natyrshme, kurse tani mungesa jote na bën të derdhim lot. Kur të vizitonim në dhomën e spitalit na thojë: “Nuk e besoj, Brukika! Por më bëhet qejfi që erdhe!” Dhe përqaftim njëri-tjetrit, pastaj bënim shaka në oborr, ndërkohë që me Zsofi-n ndjemë aromën e tymit të një nga llullave të fundit të tij. Ishe një Gjeni, dashamirësinë e të cilit e ndjemë edhe ne. Luajte një rol vendimtar që në vitin 2001 ta besonim se edhe ne mund ta realizojmë programin Profit Sharing. Nëse do të jemi në gjendje të përcjellim një pjesë të vullnetit që morrëm nga ty, atëherë lotët me kalimin e kohës do të kthehen në buzëqeshje. Të lutem kujdesu për ne nga larg, dëshirojmë t'i jemi të denjë mentalitetit tënd.

Me dashuri: Bandi dhe Teca

■ Zoltan Becz

“Gyuri Czele” është një koncept në jetën e FLP-s! Në kujtesën tonë do të jetojë përgjithmonë ashtu siç e njohëm: një njeri me humor me kapelen e tij elegante prej kashte, i cili nëse është në qejf, i ndan fjalët e mençura si ëmbëlsirat surprizë në restorant kinez. Kjo pamje e dashur jeton përgjithmonë në zemrën e familjes Becz!

■ Andras Kovacs

*“Aty ku mohimi hedh këmbën,
Do të rrezojë botën tënde.” Imre Madach*

Njëherë në Nemti bisedonim, shikonim qiellin, ku yjet ndriçonin si xixëllonjat, dhe planifikonim fatin tonë. Ti dhe unë uleshim në qetësi, duke dëgjuar zhurmën e lehtë të natyrës. Thoshe që këtu lart është mirë, thith ajrin e pastër të Matra-s, dhe në një farë mënyre qetësohem.

Herë tjetër si një mikpritës i mirë vendose një tryezë pranë tiganit të sallos, dhe ndërkohë hëngrëm me shije bukën me sallo dhe qepë të përgatitur nga ti, mes gumëzhitjes së fëmijëve. Pimë edhe verë, jo shumë, vetëm sa ta ndjenim mirë veten. Ti ndeze llullën dhe fillove të tregojë, dhe tregojë e tregojë, gjithmonë thelbin, edhe deri në mëngjes. Të kujtohet Gyuri..., dhe udhëtimet me aeroplan, autobus, anije. Hm... New York, Phoenix, Las Vegas, sa mirë ishte së bashku! Kaluan afërsisht dhjetë vjet. Dhe nuk e njihnim akoma njëri-tjetrit.

Planifikonim ndeshjet e shahut, të pingpongut, grillin, por Ti gjithmonë thoshe njëherë tjetër. Në këtë botë të nxituar, punë pas pune, mezi të mbetej pak kohë për t'u shplohur. Ju u shpërngulët, takimet dhe qenia së bashku morri fund, erdhën bisedat e gjata telefonike rreth teknikës, muzikës, programeve, makinave, rrjetit dhe shumë të tjera.

Pastaj qetësi! Dritë dhe hije, dyshim dhe shpresë, jetë dhe vdekje? Lajm i mirë! Kishe filluar diçka të çuditshme! Nuk e kuptoja të gjithën, sepse lart në mal nuk bisedonim rreth kësaj. Por kërkonim sekretet e jetës së gjatë dhe të përhershme.

S'ka gjë, thashë me vete, Gyuri çfarëdo që fillon, gjithmonë del mirë. Edhe në bisedën tonë të fundit më dhe shpresë që s'ka asnjë problem. Unë të besova si gjithmonë. Sms-i më erdhi

E përmbloidi:

EVA KESZI SZEPNE
soaring managere



E DUHUR

në një ishull të vogël, në Guadeloupe, në Antillat franceze, larg nga Ty. U lodhe në rrugën e gjatë, beteja jote ishte e pashpresë, në kundërshtim me fatin tënd, megjithëse fitove, ky ishte fundi yt! Po qëndroj për një moment, mendohem, nuk më besohet e gjitha, më punon imagjinata e ndikuar nga ndjenjat. Më vjen të ulërij! Por është vonë! Gyuri, ku po nxiton? Më thua diçka me zë të ulët, por unë nuk të kuptoj më, zëri yt humbi në detin e vetmuar të shpirtit tënd kundërshtues.

Vetëm qëndrojmë, pa fjalë, në heshtje, pa kuptuar asgjë, dhe shpirti ynë i drejtohet qiellit! Gyuri ku je, a je larg? Shpresojmë që ta gjesh rrugën për në shtëpi! Nuk kemi për të harruar! Gyuri, Zoti të bekoftë!

Aranka Vagasi dhe Andras Kovacs

■ Zsafia Gergely Czelene

Jam menduar shumë, që çfarë vlere kishin 24 vitet e kaluara së bashku? Ishte një jetë e vështirë, por e veçantë. Nuk ishte një martesë e zakonshme, pasi thelbi i saj ishte marrëveshja dhe shoqëria. Kurse forcën e përbashkët e përbënin bisedat tona të përherëshme, të cilat vepronin tek ne si endorfina. Morra tre gjëra me vlerë nga Ai. Më bëri t' i shikoj ndryshe gjërat, të mendoj gjithmonë në mënyrë komplekse dhe të jem largpamëse. Vlerësimin dhe besimin në vetvete ma ndërtonte çdo ditë – dhe asnjëherë nuk e shkatërroi. E imagjinon dot? Gjithmonë më lavdëronte, më lavdëronte, dhe krenohet me mua. Edhe ti kështu jeton, këtë merr dhe jep? Dhe dy fëmijët e mi të mrekullueshëm, Amica dhe Dani, të cilët i plotësojnë dhe i zhvillojnë mëtej tiparet më të mira të fituara nga ne, dhe ajo që tani u bë më e

rëndësishmja: me ndërtimin e biznesit Forever hodhi bazat dhe zgjidhi – prej 10 vitesh dhe deri në fund të jetës sonë – sigurinë morale dhe materiale të gjithë familjes sonë. Nga dita në ditë mund ta ndjejmë dhe ta zhvillojmë mëtej dashurinë, ndihmën e miqve dhe bashkëpunonjësve tanë, sigurinë e familjes së madhe. Çfarë do të bëhej tani me ne pa këtë?

I hoqi shpeshherë vujtjet e njerëzve që mendojnë dhe shkruajnë: A ia vlen të shkruajnë, a i pranon njëri mendimet dhe pikëpamjet e tyre? A ndryshon ndonjë gjë nga shkrimet e ndonjërit? Apo mbetet vetëm fjala e hedhur në ajër? Mund të ndihmohet që jeta e tij të lëj gjurmë edhe në jetën tënde. Nëse ke marrë diçka prej Tij, të lutem përfito nga ajo.

Jo vetëm kuptoje dhe mësoje – por edhe vepra! Edhe një mendim i fundit. I falenderojmë të gjithë ata që e deshën atë dhe ne. Për punën dhe reagimin tuaj. Faleminderit që iu kemi!

■ Miklos Berkics

Unë jam njeri i fjalëve të thjeshta. Njeriu i fjalëve të mëdha je Ti, Gyuri! Jo në kohën e shkuar, por tani, pasi mentaliteti yt ndodhet këtu mes nesh. E ndjej aromën e llullës tënde. Qëndron diku këtu, na shikon, buzëqesh, dhe thith fortë llullën tënde, vetëm ne nuk mund të shikojmë. Duke kujtuar 10 vitet e kaulara, më dalin përpara vetëm kujtime të bukura. S'ka fjalë me zë të lartë, s'ka grindje, s'ka inat dhe s'ka urrejtje. Gjithmonë e dije që është lluku i madh në jetën e njeriut të humbasësh minuta me grindje të tilla. Hm... fillimi i vitit 1997, në zyrën e rrugës Bajza po të luteshim me Ari Vagasi-n, "Gyuri firmose pra, mos luaj

me ne, ta fillojmë!" Forever ka nevojë për mësimet e njerëzve me mendime të mëdha. Pastaj erdhën prezantimet e para, sa herë jemi argëtuar kur thosha: "Zonja dhe Zotërinj, lektori i mbrëmjes së sotme është: György Czele". Dilje jashtë në mënyrë elegante dhe më thoshe në vesh: "Miklos, këtë tani mbaje Ti!" Dhe uleshe i qetë në rreshtin e parë. Kasete e parë e biznesit mban emrin tënd: *György Czele: Këshilla për fillimin dinamik dhe efektiv*. Dhe u grindëm pak, sepse harruam ta diskutonim me qendrën e kompanisë. Natyrisht ky është një material që gjendet edhe tani në magazinë. Faleminderit për gjithë mësimet që na dhe. Dhe udhëtimet... Udhëtimi i parë: Erdely, Szekelyföld... me tren. Rrugë e gjatë... Sa shumë që biseduam, thurrëm ëndrra. Dhe natyrisht edhe udhëtimet e tjera të mëdha në Europë dhe matanë oqeanit. Dhe takimet e mëdha, ku mund të flisje me çdo filozof të madh të FLP-s. Nuk pyesje që "Kujt skuadre dhe çfarë gjenerate i përket?" Por buzëqeshje dhe i jepje besim të gjithëve. Më vjen keq që të njoha dhe mund të mësoja nga mendimet e tua të mençura vetëm në 10 vitet e fundit. Njëkohësisht e di për faleminderit që pata mundësinë të të njoh dhe të jem shoku yt. Shikoj urnën ku ndodhet hiri i trupit dhe mendoj që shpirti dhe mendja është e lirë. Nuk duhet të fërkojmë urnën që të të thërrasim për ndihmë kur të kemi nevojë për Ty. Ti do të jesh gjithmonë me ne, dhe do ta shfrytëzojmë atë që na dhe. Si shumë prej nesh, edhe për Ty FLP-ja ishte "ishulli i vogël" ku ia vlen të vije. Gjithmonë qëllimi yt ishte kujdesi për familjen. Të kujdesesh për ne me të drejta autori, që të mos na mungojë asgjë kur të mos jesh në gjendje të punosh më për ne. E arrite qëllimin tënd. Arrite të krijosh diçka të pavdekshme. Emri

yt nuk do të harrohet kurrë. Ajo që krijove nuk do të fryhet nga era. I dashur Gyuri? Të premtojmë që do të sillemi mirë dhe do ta duam njëri-tjetrin. Do të kujdesemi për Zsofi-n dhe fëmijët e tu. Siç e thoshe gjithmonë: “Duke vërsëllyer edhe në mal edhe në luginë”. Dhe tani do të përmend disa rreshta nga pena jote: “Dëshiroja të thërras. Njerëz, më ndiqni sepse ia vlen! Përshkoheni deri në fund rrugën sepse është një dhuratë e madhe! Durojini vuajtjet, pëllëmbat, moskuptimin, dhe nëse është e nevojshme edhe turpin! Në fund të rrugës ndodhet shkëlqimi, vlerësimi, pavarësia, momenti i vërtetë! Dëshiroja të thërras, por nuk më doli zëri nga goja!”

■ Tamas Biro

Filloi në vitin e kaluar. Ishim në Nemti, në një fshat të vogël të qetë të Nogradit, në një pronë në faqe të kodrës, në një shtëpi të vogël me ngjyrë të bardhë – dhe përfundoi në varrezat e Gödöllőit. Unë vetëm kaq morra. Nga Gyuri Czele? Premë dru pranë shtëpisë së vogël të bardhë dhe u përpoqëm të shkëmbejmë disa fjalë. Nuk ishte e lehtë. Ai atëherë e kuptonte atë që unë nuk e kuptoj as tani, dhe ndoshta s’kam për ta kuptuar kurrë. Ndoshta i gëzohet asaj që krijoi, dhe tani na buzëqesh. Ndoshta mund të përfitojmë diçka nga ajo. E shkruajti, e tha në kasetë, dhe e dëgjua. Ishte ulur me llullën e tij të preferuar në gojë dhe dëshironte të gjente rrugën më shkurtër për ne. Apo atë ku mund të zhvillohem më shumë. Morra prej tij më shumë se 100 copë formularësh regjistrimi. Përse? Unë nuk njoh aq shumë njerëz të cilëve guxoj t’u flas rreth të panjohurës. Ai vetëm buzëqeshi. U ul në fuoristradën e tij dhe u ngjit për lart. U ula dhe po mendohesha. Pastaj disa herë në Amerikë. Pastaj njëherë në shtëpinë e tij në Gödöllő hapëm një shishe shampanjë. Ishte krenar për familjen e tij dhe që më në fund i kishte siguruar Ata. Na mungon Gyuri. Mua shumë, por e di që po bënte punën e vet, sepse

po të mos ishte kështu, nuk do të ndodhej KËTU.

Për atë ishte mjaft, por për ne jo – nga Ai. Për mua Ai ishte mësuesi, nga të tjerë nuk do e pranoja. Nga Ai mësova këtë përgjegjësi, dhe shpresoj të sillem mirë me të. Dhe nëse jo, prapë e falenderoj.

■ Laszlo Hari

E filluam në të njëjtin vit, në korrik të 1997-ës, me një diferencë prej dy ditësh. U bëmë Supervisor në të njëjtin muaj, dhe po në atë muaj edhe Manager. Kishte ditë kur flisnim disa herë në ditë, dhe në çdo rast më ndihmonte me këshillat e tija të mira. Ecnim në një ritëm aq të njëjtë, sa që edhe makinat i kishim njëlloj, dhe në të njëjtën kohë i humbëm byrzylykët e blerë në kohë të ndryshme. E ndoqi me shumë vëmendje dhe emocion fillimin e biznesit të Veronika dhe Stevo Lomjanski-t. Optimizmi i vazhdueshëm dhe gadishmëria për të ndihmuar janë shembull i përhershëm në kujtesën time. Ishte mirë të niseshe me Ty...

■ Jozsef Szabo

Mendoj me respekt dhe falenderim të madh për Gyuri-n! Është shumë e rëndësishme për mua që mund të përdor shkrimet dhe CD-t e tij. Është një vlerë e madhe që me këto mendime pasuroi gjithë rrjetin hungarez të FLP-s. Do të ishim të gjithë më të varfër po mos të ishin këto njohuri në Forever. Faleminderit Gyuri!

■ Dr. Sandor Milesz

Gyuri! Na le pas një vepër jete, dhe megjithëse nuk e jetove të gjithë gjatësinë e jetës, u përpoqe të na përcillje vetveten, dhe kur filluam të të njohim, atëherë gjithçka u shkëput...

Ndonjëherë njeriu nuk do ta besojë as atë që e sheh me sytë e vet, sepse

mendja e tij nuk do ta pranojë largimin. Pak a shumë kështu mendoj tani që pres telefonatën tënde ku thua që “Sandor kam një mendim të mirë, do t’i ndihmoja të tjerët me të, le ta publikojmë”, pastaj “Ejani të ulemi dhe të bisedojmë”, “Them ta nxjerrim në revistë atë fotografi...”. Nuk të bie telefoni Gyuri, nuk dëgjohet zëri i ngjirur, nuk mund të të them që Gyuri, vemë bast që po pi duhan, por do kisha dëshirë. Ti tani po punon në një shoqëri tjetër, e ndjejmë që je këtu mes nesh, vetëm që tani nuk na merr në telefon dhe nuk na viziton. Ne të presim...

■ Terezia Heramann

Më kujtohet prezantimi i parë i hapur i FLP-s në jetën time në Salgotarjan, të cilin pata fatin ta mbaj së bashku me Gyuri-n.

U ulëm pranë njëri-tjetrit, dhe prisja me emocion të fillonim prezantimin. Gyuri më dha besim, më rrahu shpatullat, më shtrengoi krahun dhe më tha se kishte besim tek unë. Rrezatonte forcë, e dinte se për këtë kisha nevojë në atë situatë. Unë morra përsipër pjesën e prezantimit të produkteve, kurse Gyuri mbajti pjesën e marketingut. Si një plak i urtë u ul në tavolinë dhe duke buzëqeshur bëri pyetjen: “Çfarë dëshironi të dëgjoni: planin marketing të FLP-s, apo jeni më tepër kureshtar për MANAGERIN E JETËS?”

Gjatë heshtjes fillimisht u çudita, pastaj fillova të mendoja. Pashë që edhe mysafirët dhe bashkëpunonjësit që më rrethonin u detyruan të mendoheshin pas kësaj pyetje të thjeshtë, por prapë interesante. Pastaj Gyuri u ngrit dhe programi vazhdoi përpara tabelës, sikur gjithë kjo të mos kishte ndodhur, por Ai e dinte mirë se mbolli një farë në kokën e njerëzve, dhe me këtë e arriti qëllimin e tij. I bëri të pranishmit të mendoheshin. Që atëherë më vijnë shpeshherë në mendje fjalët e urta të Gyuri-t, të cilat i morra edhe me shkrim në një konsultim.

Pastaj këto i vendosa në murin e dhomës pranë një pllakate aloe-je. Këto thënie ndodhen edhe sot në mur. Po iu them disa prej tyre:

“Nëse e pranon vështirësinë, s’jeni pjekur akoma për t’u bërë i pasur.”

“Rruga më e shkurtër mes dy pikave je vetë Ti.”

“Nëse një farë e vetme bie në vendin e duhur, çdo gjë mund të filloj nga e para.”

“Mos dashuro paratë, por pavarësinë që mund të blesh me to.”

“Nëse s’ke ëndërr, s’ke jetë,

Nëse s’ke jetë, s’ke vdekje,

Nëse s’ke vdekje, atëherë përse jeton...”

“I shëndetshëm je vetëm nëse çlirohesh nga problemet materiale.”

■ Ilona Ilyes

I dashur Gyuri! Megjithëse lamtumiria e fundit është e dhëmbshme, prapë kujtimi është një ndjenjë krenuese, i cili më sjell në mendje emocionet e takimit tonë të parë. Tek Ty njoha një njeri i cili me optimizmin e tij të përherëshëm është shembull për periudhën pasardhëse. Pe tek unë mundësinë e një forme të re jetese, të cilën nuk e kisha imagjinuar as në ëndrrat e mia më të bukura. Me një vullnet fantastik më ndihmove në mposhtjen e lëkundjeve të mia dhe mungesës së vetëbesimit. Mbay mend shumë nga fjalët e tua të mençura, por njëherë prej tyre në mënyrë të veçantë: “Çdo gjë lejohet në jetë, përveç dorëheqjes!” Dhe ky është një mësim i përherëshëm për të gjithë ata që e humbasin mundësinë për t’u bërë të lumtur me mungesën e besimit. E respektoj dhe vlerësoj aftësinë tënde të të shkruarit i cili është rezervuar i përvojave të tua të pasura për gjeneratën e të ardhmes. Të falenderoj për lumturinë time dhe të ardhmen e bukur të familjes sime!

■ Dr. Maria Pavkovics

Të gjithë kanë nja dy njerëz, nga të cilët vendoset gjithçka në jetën e tyre. Për mua ai ishte njëri.

Emrin e György Czele-s – kështu e thërrisja atëherë – e njoha në një nga librat e mi të preferuar në vitin 1995. Libri i Stuart Wilde me titull “Tryket e bërjes së parave” ishte një libër i rëndësishëm për mua. Më ndryshoi vendimet dhe me këtë gjithë jetën time. Kisha shumë respekt për autorët e tij, prandaj do t’i njihja me gjithë dëshirë ata. Disa muaj më pas – me siguri që jo rastësisht – mund t’i njihja personalisht në një rrjet vitaminash.

Doli me besim dhe entuziazëm, të cilat mua atëherë më mungonin. M’u duk e pabesueshme që mund të realizohen edhe ëndrrat që Gyuri imagjinonte, me investimin e aq energjive sa kishte investuar edhe ai.

Firma falimentoj, por ëndrrat mbetën. Disa muaj më pas u takuam përsëri. Të dy, pa lidhje me njëri-tjetrin, u shfaqëm në një rrjet më të madh të asaj kohe. Prapë Czele! Si punon! Sa besim, humor dhe dashuri ka! Sa energji sakrifikon! Sa preciz dhe perfeksionist! Kjo firmë nuk falimentoj, por shumë vetë e duronin me vështirësi mentalitetin dhe shpërblimet e saj të vogla. Ndërmjet tyre isha edhe unë. Dhe Gyuri Czele në një moment u zhdruk!

Kjo do të thotë diçka! Disa muaj më vonë më telefonoi dhe më ftoi – në mënyrë tepër elegante – në një takim biznesi, në një prezantim. Të tjerat janë pjesë e historisë së FLP-s. Jam krenare që guxova dhe munda të vendos për të ndryshuar, por kjo nuk do të kishte ndodhur pa të, pa besimin, njerëzimin dhe njohuritë e tij. Gyuri Czele ishte njeriu i vetëm që ma prezantoi në mënyrë profesioniste biznesin FLP dhe sistemin marketing, më tregoi studime krahasuese dhe më skicoi një plan biznesi tepër serioz dhe premtes 6 mujor. Gjithë këtë brenda 2 orësh! Ishte përgatitur, kishte emocione, më mbështeste në mënyrë të dukshme që të merrja vendimin dhe ishte tapër i çiltër. Pasi nuk më sponsorizonte në mënyrë të drejtpërdrejtë, por nëpërmjet një të njohuri të përbashkët.

Tek Gyuri ndërthurej entuziazmi, besimi dhe dashuria e vërtetë fëmijore me “njohurinë për gjithçka”, mendjeprehtësinë dhe mbajtjen e distancës së mjeshtërve dhe pleqëve të urtë. Tani buzëqeshjen e Gyuri Czele-mund ta shikoj vetëm në kujtimet e mia, por në mënyrë të pathyeshme. I ke shumë herët Gyuri, por le pas shumë gjurmë fisnike! Nuk ishte pa vlerë!

Me dashuri të pafund: Pavko!

■ Eva Keszi Szepne

Kur mendoj për Gyuri-n më mbushet shpirti me miqësi dhe dashuri... Shtrengoj në dorë dhuratën e vogël të marrë nga ju për nivelin e Supervisorit, mbajtësin e çelësve sot pak të vjetëruar: me mbishkrimin FOREVER TOGETHER. Si filloi... e fillova në shtator të 1997-ës me disa produkte, por me kujdes që të mos pësoj dëm të madh. Gyuri u kujdes që të ecim gjithmonë përpara. Na telefononte ose na linte mesazh.

- U bëmë manager, ia arritëm! – na tha Gyuri, dhe atëherë m’u drodh shpirti. Nëse ai e arriti, atëherë mund ta arrij edhe unë?! Për herë të parë seriozisht u takuam në dhjetor 1997 në një pub irlandez. Më skicoi biznesin, mundësinë dhe më ndezi dëshirën dhe forcën për të vepruar. Marrdhënia jonë e biznesit u kthye në një miqësi të fortë, të thellë dhe që inspirohej në mënyrë reciproke. Kishte gjithmonë besim tek unë, më ndihmonte sipas mundësive, më donte ma kusht dhe më jepte besim edhe në periudhat e vështira. Nuk mendoja se këtu dhe tani do të ndërpritej kaq shpejt... Po provoj të mbledh dhe të rikujtoj bisedat tona shoqërore dhe profesionale që zgjasnin deri natën vonë. I lexoj përsëri shkrimet, dëgjoj zërin e tij dhe shpresoj të mos i harroj fjalët e tij të mençura, dhe **në momentin dhe vendin e duhur të përdor fjalët dhe mendimet e dubura.** Të falenderoj për gjithçka!

Të përqafoj me dashuri: Eva

Një buqetë mendimesh nga Gyuri, nga **seriali i duhur**



Njeriu i duhur (... të cilin e kërkojmë dhe e gjejmë me shumë vështirësi...). Durim, vetëvlerësim. T'i kesh të dyja me vete dhe atëherë s'mund të shkatërrojnë. Pastaj më e rëndësishmja, e cila e lehtëson kërkimin: mëso, zhvilloje veten me gjithë forcat e tua, bëhu edhe vetë NJERIU I DUHUR.

Biznesi i duhur (... të cilën po ta kërkojmë me guxim, ke për ta gjetur...). Dalëngadalë m'u mbush mendja se çfarë dëshiroj me të vërtetë:

1. Një biznes ku nuk duhet të investoj shumë para, duke rritur në këtë mënyrë rrezikun personal.
2. Një biznes ku nuk duhet të harxhoj shumë kohë dhe energji.
3. Një biznes i cili pas një kohe nuk varet vetëm nga pjesëmarrja personale.
4. Një biznes të cilin gjatë jetës sime duhet ta ndërtoj vetëm njëherë, pastaj të kem qetësi.
5. Një biznes i cili zhvillohet në rrethin e miqve dhe familjes.

Vendimi i duhur (... të cilin është vështirë ta marrësh, por jo shkatërrues...). Vendos se ku dëshiron të jetosh: Poshtë apo lart, në anën e errët apo të ndritshme të botës! Vendos që zgjedh varësinë apo pavarësinë! Vendos që zgjedh varfërinë apo pasurinë, vujatjen apo jetën pa halle!

Mentaliteti i duhur (... sfidat e mijëvjeçarit të tretë...). Njeriu cilësor mendon gjithmonë me afat të gjatë kohe. Qëndron larg mënyrës së jetës së njerëzve të momentit, "të parave të ditës" dhe gjithçkaje që i shërben vetëm të tashmes. Njeriu cilësor beson se puna e investuar shpërblehet në çdo situatë, nëse jo tani, atëherë më vonë.

Njeriu cilësor kërkon gjithmonë suksesin. Pavarësisht sa herë dështon në jetë dhe biznes, prapë është i aftë ta fillojë nga e para dhe të rinovojë. Sepse pikësynimi i tij është arritja e qëllimit: të bëhet i suksesshëm. E di se në rrugën drejt suksesit duhet të përballojë një seri disfatash, por e di edhe se nga disfatat Do të mësojë shumë. Nuk i intereson opinioni i njerëzve të tjerë, edhe nëse e quajnë të çmendur apo e qeshin. Sigurinë e brendshme e ka të pathyeshme.

Durimi i duhur (... sa i vështirë është praktikimi, aq i rrallë dhe me vlerë është...). Mbaje mend: talenti nuk është aftësia e të folurit në mënyrë brilante dhe as agresiviteti, por më tepër këmbëngulja dhe durimi janë armët e tua të vërteta. Sot tregohu pak më i duruar se dje dhe nesër tregohu pak më i duruar se sot. Ec nga hapi në hap. Dhe do mahnitësh nga rezultati: do të përmirësohet efektiviteti i punës, do të arrish rezultate më të qëndrueshme, do të bëhesh më i ekuilibruar dhe më i kënaqur. Do të respektojnë gjithmonë e më shumë njerëz, dhe nëse i shërben, disa prej tyre do të duan. Dhe duke u bërë gjithmonë edhe më i duruar, do të pasurohesh gjithmonë e më shumë në aspektin fizik dhe mendor gjithashtu.

Beteja e duhur (... të cilën duhet ta luftosh, por të cilën mund ta pëlqesh vetëm pasi e luftove...). Të kesh vetëm një qëllim: duke ecur gradualisht, gjithmonë e më i sigurt në këtë botë, të arrish nivelin më të lartë emocional, shpirtëror dhe material (financiar), ndërkohë që mëson shumë dhe ua përcjell ato edhe të tjerëve. Do të arrish gjendjen e sigurisë emocionale, shpirtërore dhe materiale, ndërkohë që ndihmon të tjerët që edhe ata të kenë sukses në këtë rrugë.



FARKAS GABORNE
ANKICA PIRI
GABOR FARKAS
managerë

Disfata është korridori i suksesit

Më lejoni t'iu thërras vëmendjen për disa mendime, dhe në universitet tregohuni tolerant përsa i përket mangësive në stilin e shkrimit, sepse këto rreshta nuk po shkruhen nga shkrimtarë me titullin Kazinczy.

Duke shfletuar numrat e mëparshëm të revistës mund të takohemi me të ashtuquajturat „historitë e suksesit”. – ishte vetëm, nuk u morr njeri me të, por prapë pati sukses..., – s'e morrën seriozisht, luftoi dhe pati sukses..., – e hoqën nga puna, të gjithë i kthyen shpinën, por pati sukses...

I besoja dhe jo këto histori.

Me thënë të drejtën, unë nuk di të shkruaj vetëm për suksese. Për faktin se ndryshimi i pikëpamjes së bashkëshortes sime – i cili në pamje të parë nuk pati shumë sukses tek unë – nuk më bindi, madje ajo duhet të ecte kundër rrymës (për këtë i kërkoj të falur). Nga se apo nga cili bëhet një histori jete e suksesshme apo e dështuar?

Jeta e secilit prej nesh është një histori, skenari i të cilës shkruhet nga fati apo zgjidhja e halleve – si do që ta quajmë –, por fakti që në historinë tonë do të bëhemi personazhe kryesore apo dytësore, kjo varet vetëm nga ne. Natyrisht me këtë nuk dua të them se të jesh personazh dytësor nuk është diçka

e mirë, por zakonisht personazhi kryesor mbahet mend më mirë në fund të filmit.

Nëse je i aftë për ndryshime, atëherë ndryshon edhe mjedisi yt! Sa i zgjuar ishte ai që e zbuloi këtë? Por sidoqë ta marrim këtë fjali, prapë duhet ta gëlltisim si fëmijët e vegjël shurupin (më fal xhelin Natur).

Të ndryshosh, të besosh, të dish, të luftosh, këto janë të gjitha fjalë, kuptimin e të cilave e dimë mirë, por prapë nuk i fusim me gjithë qejf në skenarin e jetës sonë, dhe nëse e bëjmë, i vendosim me shkronja të vogla në fund. Nëse arrijmë të adaptojmë kuptimin e fjalëve dhe t'i nisemi rrugës, në fund të së cilës mendojmë se mund ta hedhim nga supi thesin e imagjinuar, atëherë duket se ky është vetëm një stacion ku ndalojmë të marrim një frymë dhe t'i themi vetes që edhe këtë e arritëm. Por të mos harrojmë që nuk jemi akoma tek qëllimi. Pra, duke ditur këto pasojnë disa kujtime nga bashkëshortja ime, pasi kujtesa i zbukuron pengesat e kapërcyera.

„Një burrë pa besim, i cili që atëherë e merr vetë flamurin”

Punoja në një institucion financiar të huaj si njeri me dy diploma, plot me ambicie dhe entuziazëm. Nuk kisha ndonjë problem dhe isha e kënaqur me atë që kisha arritur, pasi punoja në vendin e punës që ëndërroja.

Në thelb isha pionere e mendimit materialist dhe praktik, duke e ndërthurrur këtë me shifra dhe kamata.

Asnjëherë nuk më kishte shkuar ndër mend të ndërtoja rrjet, pasi për mua kjo nuk do të thoshte tjetër, veçse bezdisjen e të tjerëve. Dhe kisha një mendim rreth njerëzve që e merreshin me të.

Por prapë si përfundova këtu me një qëndrim të tillë? Kjo ndodhi falë sponsoreve sime, **Ibolya Czaszar**. Ajo ishte ndryshe, nuk dukej agresive dhe e ngjitur. Pastaj ajo që punonte me llogarinë e saj bankare nuk ishte diçka e zakonshme. Mua më bëri kureshtare qarkullimi i parave në llogarinë e saj. Aq sa u ulëm të bisedonim, e cila më pas u ndoq nga shumë biseda të tjera pranë një kapuçinoje. Nuk ishte plani marketing, por më tepër rrezatimi i saj që më tërhoqi dhe ma bëri më simpatike çështjen.

Më pëlqente t'i mbështesja faktet me profesionizëm, prandaj në një nga takimet e shumta morra edhe një shoqen time farmacistë, e cila e armatosur me kompetencën e saj profesionale e dëgjoi në mënyrë kritike planin marketing dhe produktet që për mua atëherë tingëllonin në gjuhën kineze.

Ishte një ndjenjë e çuditshme që kritikun që solla me vete për ndihmë i pëlqeu, kurse mua jo! Mendova se asaj i përshtatet kjo gjë nga ana profesionale, kurse unë po qëndroj më mirë në çështjet financiare. Aq më tepër që nuk merrja vesh nga çështjet mjekësore. Me këtë mendova se detyra ime morri fund. Por e mendova gabim, sepse Ibolya tha se jam me shumë fat që gjeta një bashkëpunonjës që me rastin e parë.

Nga përvoja me siguri edhe ju e dini që çfarë bën frika nga dështimi tek njeriu. Por nuk duhet të kemi frikë nga asgjë, vetëm nga frika – tha Roosevelti – por pavarësisht nga kjo

brenda meje ky proces nisi dhe e nënshkrova formularin e regjistrimit. Puna e shoqes sime farmacistë nisi shumë mirë, kurse unë nxirrja pretekste nga më të ndryshmet, i shkoja pas gjithçkaje, pyesja për gjithçka... nuk ishte e lehtë me mua (Gabor Farkas).

Aktiviteti i parë në të cilin morra pjesë ishte Lakitelek. Me thënë të drejtën i shikoja pak i habitur njerëzit, sepse pashë një mënyrë sjelljeje plotësisht ndryshe nga ajo që deri tani mendoja se ishte normale gjatë praktikës sime në bankë (psh. të gjithë buzëqeshnin, përqafonin dhe duartrokisnin njëri-tjetrin). Kjo ishte e pazakontë për mua. Pastaj në fund të ditës mendova se nuk janë këta njerëzit që ecin kundër rrymës, por jam vetë dhe të tjerët si unë. U ktheva në shtëpi dhe i thashë familjes sime që këtë biznes do ta ndërtoj edhe unë. Burri im nuk e kuptoi ndryshimin e menjëhershëm, tha që të qetësohem dhe të ta kthej prapa kutinë touch, ndoshta e shkëmbejnë. Meqë e pa se nga ana ime vendosmëria kishte kaluar në angazhim, ma NDALOI këtë gjë, e cila natyrisht tek unë pati EFEKT TË KUNDËRT. Në këtë kohë tek Gabori nisi një proces i gjatë, të cilin në Szeged e quajmë **efekti NDM**. Ky përbëhet nga inicialet e fjalëve **Ndaloj-Duroj-Mbështes**. Sa e bukur? Një familje e cila lufton krahë për krahë „për suksesin”, por edhe kjo kishte të bukurën e saj! E dimë se në të njëjtin drejtim me erën është e lehtë të ngasësh anije me vela, por në drejtim të kundërt, kjo është një luftë e vërtetë!

Filloi të më interesonte me të vërtetë biznesi dhe mendova se mua më mjafton edhe 1 orë punë në ditë. Po ta mendoja mirë nuk kisha ndonjë qëllim me të cilin do të kaloja në qendër të vëmendjes. Ti ke ndonjë qëllim? Edhe unë u përkisja nëpunësve të cilët jetonin sipas zakoneve. Shkoja rregullisht në aktivitete dhe doli gjithmonë e më mirë në pah e vërteta, të cilën e kisha

gjithmonë përpara syve. Më verbuan edhe mua mendimet e gabuara që kishin programuar në trurin tim. Ngulim këmbë pas gjërave të caktuara, kemi besim tek ato, kur janë pikërisht ato që na shkaktojnë gjithë vuajtjet. Nga janari 2005 nuk mund ta nxirrja më pretekstin që s'kam kohë, pasi duke qenë dy muaj shtatzanë morra leje. Zgjerova vazhdimisht. Më 19 mars na lindi djali dhe më mungonin vetëm katër pikë nga niveli i supervisorit. Duke e menduar, atëherë bëra gjëra jo të zakonshme, sepse pikërisht një ditë përpara lindjes në bufenë e klinikës punonim me sponsoren time për pikët e mbetura.

Ndërkohë burri im e pa se nuk mund të ndikojë në biznesin tim. Vetëm duroi e duroi.

Pastaj erdhën gjashtë muaj pushim „për shkaqe teknike”. Ai që ka fëmijë e di se përse mendoj. Edhe gjatë kësaj kohe kujdesesha për blerësit e mi dhe Ibolya më ndihmonte t'i mbaja në qendër të vëmendjes bashkëpunonjësit e mi. Pasi Adam-i u bë gjashtë muajsh, e fillova përsëri punën. Ai flinte në karrocë, kurse unë vetëm flisja, flisja e flisja...

Pastaj pasdite shpërnguleshim në zyrën e Szegedit. Adam-i hapat e para i hodhi në qilimin me pulëbardhën blu. Pavarësisht nga dorëheqjet e shumta dhe kontaktet e syve herë përbuzës, herë mbështetës, rezultati nuk po vinte. Tani e di se nuk bëra gjithçka në interes të suksesit, nuk tregova përruljen dhe vëmendjen e duhur.

Në shkurt 2006 në jetën tonë ndodhi një ndryshim rrënjësor, rreth të cilit flas gjithmonë me vështirësi. Shkatërrim i plotë, por sot e di se kjo disfatë nevojitej për të parë atë që e kisha deri në fund përpara syve. Ju e keni të qartë se çfarë ofron FLP-ja?

Rrugëzgjidhen nuk e morrëm gati – megjithatë e kishim përpara

syve -, pasi nuk dinim akoma të mendonim. Pastaj pas disa netësh pa gjumë lindi vendimi që i vuri të gjitha përpara: s'ka tjetër pas, veçse përpara përsëri! Nuk doja të isha një njeri i cili dorëzohet lehtë. Vendos më në fund! Mos prit të ndodh diçka që të vë në lëvizje!

Sponsorja ime ishte në Malajzi, asnjëherë nuk kisha pritur aq shumë njerëz se sa kur prita Atë. Vendosa që nuk dua ta pranoj atë që ndodhi, nuk dua të mar të përpjetën, dhe filluam të planifikojmë me forca të përbashkëta. Morra forcë, e dija se duhet t'i hedh me rregull hapat që më çojnë përpara në jetë. E kuptova se çfarë do të thotë FLP-ja për mua. Një forcë e madhe më ngriti në këmbë dhe unë përfitova nga mundësia.

Në mars marrëm vrull, pastaj erdhën përpjekjet e fundit. Për Adam-in një vjeçar kujdesej nëna ime, për të cilën e falenderoj shumë. Kishte mbrëmje kur djali nuk donte të vinte në shtëpi me mua, duke u kapur pas qafës së gjyshes qante: Ai do të qëndronte më, sepse e ndjen veten mirë pa mua... Këtë ndjenjë nuk ia uroj asnjërit, por e dija se çdo periudhë e keqe merr fund njëherë, pra edhe kjo është një gjendje kalimtare.

Prilli solli nivelin e assistant managerit. Me familjen time mezi e mbaja lidhjen.

Erdhi vera, kur në argëtimin e Adam-it u integrua edhe vjerra ime, gjë e cila më erdhi mirë, ishte një ndihmë e madhe.

Përsëri planifikim, përsëri punë! Në qershor 2006 në jetën e burrit tim mbërriti faza e fundit e efektit NDM, kur filloi të më mbështeste me gjithë forcat. Kjo ishte një ndihmë e madhe si për shpirtin, edhe për pikët e mia. Tregohuni të duruar, këmbëngulës, ambicioz dhe mjedisi juaj do ta shohë më në fund atë që shikoni ju!

Qershorin e mbylla me 44 pikë. Shumë njerëz mund të mendojnë se nuk mund të bëhet kaq shpejt! Për asnjë moment nuk më shkoi ndër mend që nuk do ta arrij nivelin e managerit. Po ta mendoj mirë, kjo më çoi përpara. U përqendrova vetëm tek qëllimi dhe nuk dëgjova asgjë që ju mund të keni dëgjuar. Në korrik arrita 76 pikë! Sa e çuditshme, edhe unë kam lindur në korrik të 76-ës! Kjo ishte një dhuratë e bukur ditëlindjeje.

Si përfundim nuk duhet të harrojmë që në skenarin e historisë sonë personazhet dytësore shpeshherë luajtën rol kryesor. Falenderoj sponsoren time **Ibolya Csaszar, Skuadrën dhe Familjen time.**

Suksese të shumta!



ANDRIJA DAMNJANOVIC
manager



Si filloi? Në verën e vitit 1998 Dr. Jozsef Benka më ftoi në një leksion. Më tha që nuk e dinte se përse bënte fjalë, por i kishte premtur shoqes së tij që do të shkonte, prandaj m'u lut që të shkoja edhe unë me të që të paktën të mos ndihej i vetmuar. Tha edhe se leksioni mbahej në një sallë ku pija ishte falas. Unë jam një person kurioz, prandaj nuk i duhej të më lutej shumë.

Rreth nëntë vit kalova në FLP

Në sallë një grua nxorri disa produkte në tryezë dhe filloi leksionin. U prezantua: quhet Veronika Lomjanski dhe është distributore e produkteve ALOE VERA në Novisad. Shpjegoi efektin e produkteve dhe që konsumimi i tyre është i domosdoshëm për çdo njeri.

Jam jo vetëm kurioz, por njëkohësisht edhe dyshues. I keni parasysh njerëzit e tillë? Jeni takuar gjatë punës suaj me të tillë? Karakteri im i fortë i pranoi me vështirësi ato që u thanë, por e kuptova në kohë që me një qëndrim të tillë mënjanohem nga efektet e mira dhe shkaktoj vetëm mosmarrëveshje. **Njëlloj si kur një tregëtar iu përgjigj kërkesës së blerësit që "... nuk ka patur, dhe nuk e di se kur do të ketë". Dhe kur pronari i dyqanit e dëgjoi, filloi t'i bërtiste punonjësit të vet që përse nuk iu përgjigj që "Për momentin nuk e kemi mallin që kërkonti, por e kemi porositur". Por çfarë deshte blerësi? – e pyeti i nxehur. Më pyeti – tha punonjësi – që a ka patur shi sot. Iu përgjigja që jo, dhe nuk e di se kur do të ketë.**

Shpeshherë marrim vendime të pamenduara pa e ditur se përse japim mendim. **Veprimet tona janë të lidhura me mendimet dhe jo me realitetin.**

Kur Veronika foli rreth pavarësisë materiale, ajo nuk më interesonte shumë, sepse kisha biznesin tim, makinë të mirë, si edhe në pushime mund të shkoja kur kisha dëshirë. Kështu ishte derisa bëri pyetjen e mëpasshme: **"A keni aq para sa mund të thoni që nuk keni nevojë**

për më shumë?!" Atëherë u mendova seriozisht për jetën time. Jeta është një dhuratë në të cilën e vendosim ne se sipas çfarë rregullave e luajmë. Nëse e pranoni jetën e dhënë ashtu siç është, e keni përvetësuar siç duhet shkencën e jetës. E njihni fabulën kur **i mençuri tregon Hënën, por i padituri nuk e shikon, sepse shikon vetëm rrugën e tij.** Shumë njerëz shikojnë vetëm atë që duan të shikojnë, dhe jo atë që i tregojnë. Të gjithë kanë veshë, por jo të gjithë i dëgjojnë këshillat e mira, sepse zhyten në mendimet e veta. Tregohuni të duruar edhe me ata. E di që do të tregoheni të tillë, ashtu siç u tregua me mua Veronika në atë leksion. Të gjithë e dimë që njerëzit e qeshur janë gjithmonë të mirë, por njerëzit e mirë nuk janë gjithmonë të qeshur. **Ndihmohuni njerëzit që të qeshin dhe t'iu mbushet zemra me kënaqësi, sepse çdo njeri pritet nga një mundësi shpëtimi të cilin ua ofroni ju.**

Nuk ekziston problem i pazgjidhshëm nëse zbatoni këshillat e sponsorit tuaj. Nëse mendoni se jeni ashtu siç iu tregojnë armiqtë, atëherë nuk e njihni siç duhet vetveten. Mos u bëni "dikush", "diçka", "të tillë" apo "të atillë"! Të jeni gjithmonë të pastër, njerëz me zemër të hapur të cilët kanë qëllime për të ralizuar. Kështu mund të keni sukses. **Për këtë më mësoi edhe mua Veronika dhe Stevani.**

Nuk e kishin të lehtë me mua, por e dimë se çfarë zemre dhe durimi kanë për të gjithë ne. I përcjellin në mënyrë të shkëlqyer njohuritë e tyre. Ai që nuk e bën këtë është

teve që

Disa u dorëzuan,
por unë nuk u përkas atyre!

si qerosi që mbedh krehër.

Edhe ju përcilluani njohuritë tuaja bashkëpunonjësve tuaj dhe ndihmojini ata ta kryejnë po aq mirë punën e tyre si ju. Njohuritë e marra në çdo kurs përgatitor përcilluani edhe bashkëpunonjësve tuaj në thellësi. Njohuritë e përcjella në kohë sjellin rezultate më të mëdha.

Përcjellja e njohurive është arteria e çdo pune.

Shumë pengesa krijohen pikërisht nga mungesa e diskutimeve dhe përcjelljes së njohurive në kohën e duhur. Shpeshherë nuk i shikojmë njerëzit ashtu siç janë në të vërtetë, por ashtu siç dëshirojmë ti shikojmë ata. Kur i shikojmë ata në pasqyrën e shtrembër të paragjyqimeve tona, nuk mund të japim njohuritë e duhura. **Përcillini njohuritë tuaja, sepse kjo është një ndihmë siç është buzëqeshja juaj, e cila kthehet gjithmonë nga ai të cilit ia tregoni.**

Është pretekst kur thoni që s'keni kohë ta dëgjoni deri në fund sponsorin tuaj. **Kjo është si të kosisni me kosë jo të mprehtë, dhe nuk e mprehni pavarësisht se e keni në dorë gurin mprehës.**

Mund të humbisni shumë kohë nëse nuk punoni siç duhet. **Shfrytëzoni njohuritë dhe përvojën e sponsorëve,** sepse ky është një mjet i shkëlqyer për të ecur përpara.

Me ndihmën e Veronikës dhe Stevanit edhe unë jam këtu, me gjithë të mirat dhe gabimet, sukseset dhe disfatat e mia. Jam këtu që edhe unë t'iu ndihmoj juve, dhe së bashku me ju t'u gëzohem sukseseve tuaja. Ndërtojeni urën e miqësisë dhe dashurisë, tregohuni të duruar dhe do ta shikoni se do të keni sukses!


Çdo mësues gëzohet kur nxënësit i tejkalojnë arritjet e tij. Për mua përbëjnë një gëzim të madh 120 managerët që janë zhvilluar në

thellësinë e rrjetit tim gjatë nëntë viteve të kaluara.

Gëzohem akoma më shumë me shtatëdhjetëepesë fëmijët ALOE të lindur. Përbën një vlerë të papërshkrueshme për secilin prej nesh edhe shëndeti i rifituar me ndihmën e produkteve ALOE. Janë të shumtë ata që kanë zgjidhur vështirësitë e tyre materiale, dhe tani jam shumë i lumtur që i përkas familjes së madhe FLP.

Për gjithë sukseset e mia falenderoj sponsorët e mi diamant managerë **Veronika dhe Stevan Lomjanski.** Edhe në të ardhmen do ta vazhdoj rrugën në të cilën më udhëhoqën deri tani, sepse kështu mund t'i realizoj **qëllimet e mia.**





DR. TAMÁS SZABO
senior manager



Është një kënaqësi e madhe për mua që me rastin e Success Day mund të ndaj mendimet e mia me Ju, Miqtë e mi, dhe dëshiroj menjëherë të përfitoj nga rasti që t'i shpreh falenderimet e mia njeriut që ka meritën më të madhe në fluturimin e Hungarisë dhe rajonit të saj, të cilit i dimë për faleminderit kushtet e denja të punës sonë dhe të cilin unë e falenderoj për respektin e jashtëzakonshëm që tashmë për herë të dytë mund të qëndroj këtu përpara jush – faleminderit Sir Alexander Dr. Milesz dhe të premtoj që me punën time do të bëj gjithçka që sot të mos marr pjesë për herë të fundit në programin e Success Day.

Betimi i vë në zemrën

Përshëndetje të gjithëve! Miqtë e mi të dashur! Sot shpirti im i drejtohet shpirtit tuaj.

Betim. Nuk e di çfarë ndjenjash dhe mendimesh lindin tek Ju kur dëgjoni fjalën betim. Gjatë jetës sonë duhet të betohemi disa herë.

Njeriu detyrohet shpeshherë të bëjë betim, kur mbaron një shkollë, kur hyn në një organizatë apo në një vend pune, apo me rastin e një aktiviteti sportiv apo feste.

Forever nuk kërkon betim, nuk të detyron në mënyrë të rreptë të bësh betim me fjalë të përcaktuara nga punëdhënësi, shkolla apo organizata – pasi një betim i tillë nuk vlen shumë. Betimi i vërtetë lind vetë, pa sforcim, në zemrën dhe shpirtin tënd.

Edhe unë kam bërë shumë betime, jam betuar kur u emërova doktor, kur hyra në urdhrin e avokatëve, kur u bëra kalorës dhe kush e di se sa herë... Asnjëherë nuk e kam ndërjerë solemnitetin e vërtetë në zemrën time, nuk më është mbledhur gryka gjatë betimit, e bëra si detyrim, pa të cilin nuk mund të merrja dot lishencën e dhënë, nuk mund të bëhesha dot anëtar i organizatës. Natyrisht ndërmjet këtyre ka patur edhe momente të rëndësishme, të cilat kanë përcaktuar një pjesë të mirë të jetës sime, por gjatë dhënies së betimit më ka folur goja dhe jo shpirti.

Solemnitetin e vërtetë e ndjeva kur bëmë betimin e martesës sonë. Kjo ishte diçka tjetër, unë desha ta bëja këtë betim, dhe u betova vetë,

i mbushur me dashuri, që të jem partner besnik i bashkëshortes sime – në të mira e në të këqija.

Një flakë dhe betim i vërtetë në zemrën time lindi kur më lindi vajza, dhe u betova me shpirt të pastër që do ta mbroj me jetën time nga gjithçka këtë jetë të vogël që krijuam. Pra, betimi i vërtetë për mua ishte krijimi i sigurisë dhe lumturisë për familjen time.

Dhe për këtë kërkova mundësinë, punova shumë, u përpoqa të bëja një punë të mirë, por gjatë kësaj nuk mund t'i shikoja pothuasje aspak ata për të cilët e bëja gjithë këtë: familjen time. Dhe zgjidhja ishte deri në fund përpara syve të mi, sepse disa muaj pasi më lindi vajza morra vesh rreth qenies së Forever-it dhe e dëgjova mundësinë materiale që vjen nga kjo nga goja e **Jozsef Szabo-s**. Por për fat të keq dëgjova fjalën e një njeriu të lig që e konsideroja shok dhe nuk bëra atë që duhet të bëja.

Do ta kisha humbur ndoshta përgjithmonë mundësinë e jetës sime po të mos kisha një bashkëshorte e cila me një luftë këmbëngulëse disa vjeçare e mposhti kufizimin, fodullëkun, ngushtësinë time, dhe solli në jetën tonë pavarësinë, sigurinë, dhe vlerësimin material që vjen së bashku me dashurinë dhe vlerësimin moral – pra JETËN. Kjo JETË ndezi shumë zjarre në shpirtin tim, njëra më e bukur se tjetra, zjarre pa egoizëm dhe agresion, këto zjarre janë managerët tanë, **Maria Jedit, Dr. György Szilagyi dhe Dr. Eva Molnar Dr. Szilagyi, Imre Kovacs, Szabolcs Szakaly**

rtetë lind tënde

dhe Magdolna Szilagy Szakalyne, Sandor Nagy dhe gruaja e tij, Kati, Zsolt Györi dhe Anita Garai dhe njerëzit që së shpejti do të bëhen manager, **Zoltan Szavo dhe Andrea Lupo Szavone, Dr. Denes Kozma, Janos Toth.** Këto zjarre janë ata njerëz të cilëve ua di shumë për faleminderit, **Jozsef Szabo, Dr. Anna Schmitz, Zoltan Ramhab, Dr. Adolf L. Kosa, Miklos Berkics.**

Shumë njerëz më pyesin që nuk më vjen keq për gjithë atë që lash pas. Jo. Në krahasim me dashurinë dhe bukurinë e shumë, ajo që lash pas është zilia, shtypja dhe rivalizimi. Në krahasim me sigurinë dhe pavarësinë, ajo që lash pas është skllavëria si avokat, efekti – “zura një avokat”.

Nuk dua të qahem. Unë e desha edhe atë, unë e dua edhe këtë. Edhe aty bëja para, edhe këtu bëj para. Aty nuk isha i lumtur, kurse këtu jam. Kaq. Asnjëherë nuk do mund t'ia shpërblej dot gruas sime që më solli në këtë rrugë dhe është partnerja ime në punë.

Sado mirë që shkojnë punët, ndodh që njerëzit kanë ditë të vështira. Kur u ngrita nga gjumi pas një dite të tillë, gruaja më kishte shkruar një letër ku lexohej edhe një vjershë:

Burri përpara pasqyrës

*Nëse e merr atë që dëshiroje,
duke luftuar,
Dhe bota një ditë të bën mbret,
Shko përpara pasqyrës
dhe shiko veten,
Dhe shiko se çfarë do të
thotë ai burri.*

*Sepse ai nuk është as nëna,
as babai, dhe as gruaja jote,
Ai që ka mendimin më të
rëndësishëm rreth Teje,
Që ka gjykimin më të rëndësishëm
në jetën tënde s'është tjetër,
Veçse burri që të shikon nga pasqyra.
Atij duhet t'i vish pas qejfit, me
zërin e të tjerëve mos u merr,
Pasi Ai është i vetmi që do ta
kesh gjithmonë shok.
E ke kaluar edhe provën
më të vështirë,
Nëse burrin që të shikon
nga pasqyra e ke shok.
Mund të jesh kushdo, edhe i
suksesshëm,
Por burri në pasqyrë të thotë
që je pa vlerë,
Nëse nuk mund ta shikosh në sy.
Mund ta gënjeshtrosh
për vite me radhë,
Dhe mund të meritosh rrahje
shpatullash,
Por fundi do të jenë lotët
dhe thyerja e zemrës,
Nëse gënjen burrin që të
shikon nga pasqyra.*

Bashkëshortit tim të dashur,
Tamas. Lexoje gjithmonë kur të
lindin dyshime, kur je pa qejf, kur
lëkundesh!

Me aftësitë dhe këmbënguljen
tënde mund të arrish gjithçka, edhe
pikësnyimin më të madh! Nëse e
dëshiron, nëse e dëshiron shumë.

Unë të kam qëndruar gjithmonë
pranë në kohët e vështira,
atëherë edhe tani së bashku jemi
të aftë për gjithçka!!! Mund ta
arrijmë!!! Bashkëshortja jote e
dashur: Ibolya.

Falenderoj gjithashtu vajzën time,
Mercedesz, e cila më jem besim,
më mbështet dhe jam i sigurt që
në moshën 18 vjeç e dy muaj do të
bëhet manager e Forever-it!

Një ditë vajza ime më çudit me këtë
fjali: “Baba, asnjëherë mos ndalo
në mes të rrugës, sepse nuk e arrin
dot qëllimin!” Tani afër kur ula
mbrojtësen nga dielli në makinë, më
ra në prehër një letër ku vajza ime
kishte shkruar po këtë fjalë dhe e
kishte fshehur në makinë që ta gjeja.
Në jetën time kam qenë krenar për
shumë gjëra, por asnjëherë s'kam
qenë me të vërtetë krenar për veten
time. Tani që qëndroj këtu përpara
jush, Miqtë dhe Skuadra ime e
mrekullueshme, mund të krenohem
me veten time dhe mendoj se Nëna
ime, e cila për fat të keq s'mund
ta përjetonte këtë, sot është tepër
krenare për djalin e saj.

Pavarësi, dashuri, siguri – unë e
kuptova dhe të lutem që edhe Ti ta
kuptosh që këto i meriton secili prej
nesh, por vetëm nëse shpirti ynë
nuk mbushet me mendjemadhësi
dhe paturpësi, por me përulje dhe
falenderim për gjithçka që mund të
përjetojmë në jetë. Pra, në jetën time
u ndezën shumë zjarre të vogla dhe
këto zjarre të vogla u bashkuan në një
zjarr të madh, në zjarrin e respektit
dhe dashurisë, dhe në shpirtin tim
pa asnjë detyrim lindi betimi, fjalët e
të cilit nuk m'i diktoi askush: do t'u
qëndroj gjithmonë besnik Juve, Miqtë,
Vëllezërit, Bashkëpunonjësit e mi, do
të qëndroj gjithmonë besnik ty Rex,
të cilit ia dimë për faleminderit këtë
mrekulli, do të qëndroj gjithmonë
besnik ty Forever!





**SVETLANA
KLENKOVSKI**
managere



**U uroj të gjithëve
një ditë të bukur! Sot kam
nderin e madh të flas rreth
vetes dhe rolit tim në radhët
e kompanisë Forever
Living Products.
Jam e sigurt që këtë e
meritova me punën dhe
dashurinë time për bimën e
mrekullueshme Aloe.**



E DUA FLP-N...

Admirimi im nuk më është ulur aspak gjatë gjashtë viteve të kaluara. Përparimi im vazhdon mëtej në rrugën e shkelur pas nivelit të managerit drejt arritjes së pikësnyimeve edhe më të larta. Përdor gjithë njohuritë e mia që si atyre që marrin pjesë për herë të parë në aktivitetin tonë, edhe atyre që vijnë këtu prej kohësh, t'ua përcjell me zjarrin e duhur mendimet dhe historinë time rreth momenteve kyçe të karrierës sime.

Me burrin tim sportist, me Baranko Klankovski-n me zemër të madhe lojtari, krijuam një familje të lumtur.

kemi katër fëmijë dhe pesë nipër e mbesa të vogla.

Kam punuar si nëpunëse në një bankë. Kam udhëtuar shumë, dhe gjatë udhëtimeve të mia zyrtare kam parë gjithë botën. Natyra ime jo e qetë dhe etja për sukses më sollën mundime të mëdha. Puna më mundoi jo vetëm nga ana fizike, por edhe nga ana shpirtërore, por prapë nuk bëja më shumë para se sa mjaftonte për të mbijetuar. Isha e pakënaqur dhe e trishtuar. U sëmura plotësisht në punë. Hoqa dorë nga banka dhe krijova biznesin tim privat. Për fat të keq edhe ky nuk

solli ndryshim të madh në jetën time. Më dukej vetja sikur vërtitesha në një det me stuhi dhe nuk mbahesha në asgjë që më jepte siguri. Dija të notoja, por i shikoja si e pafuqishme dallgët e mëdha që më afroreshin dhe më kërcënonin të më mbysin përgjithmonë. Dhe njëherë errësira e madhe u thye nga rrezja e ndritshme e shpresës. U shfaq dikush i cili më hodhi gomën e shpëtimit. Atëherë varej vetëm nga unë që e pranoj ndihmën dhe largohem nga deti i egërsuar, apo e refuzoj dhe mbytem përfundësisht. Shpëtimtari im, ju me siguri e mendoni, ishte SPONSORI IM! (E felenderoj shumë Dragana

Janovi Novakovi-n për këtë ndihmë të madhe)

Në vitin 2000 tek fqinjët e mi morra pjesë në një prezantim që bënte fjalë rreth produkteve të shkëlqyera Aloe të kompanisë FLP. Atëherë nuk e dija akoma se çfarë dëshiroj, sepse brenda meje përziheshin ndjenja të ndryshme. Nuk mund ta pranoja gjendjen time, por nuk e dija se a mund ta ndihmoj vetveten. Çdo ditë nxirra pretekste, sepse nuk e pranoja se të sëmurët mund të ndihmohen në rrugën drejt shërimit edhe nga një produkt që nuk është ilaç. Burri im u përpoq me gjithë forcat e tij të më mbushte mendjen të konsumoja produktet Aloe, sepse si sportist profesionist vështirësitë në lidhje me sportin nga dita në ditë mund t'i mposhte vetëm me marrjen e plotësuesve ushqimor me bazë natyrore. Ndodhi mrekullia! Ia dëgjova këshillën dhe për tre muaj mposhta miomën e krijuar në organizmin tim! Dhe duhet të shkonim në operacionin e planifikuar! Sot e di që produktet e FLP-s mund t'i konsumoj e qetë dhe më pëlqejnë shumë, sepse ato më shpëtuan nga stuhia më e madhe e jetës sime. Besoja plotësisht tek produktet dhe luftoja mëtej për shëndetin tim. Në prezantime me siguri keni dëgjuar shpeshherë nga miqtë tuaj më të mirë (sponsorët) rreth forcës së besimit. Këtë mua ma shpjegoi Dragana Novakovic-i im e dashur.

Sponsorët tuaj kanë dalë deri tani nga disa stuhi me ndihmën e sponsorëve të tyre, prandaj e dinë mirë se si duhet t'ua përcjellin njohuritë e tyre bashkëpunonjësve të ardhshëm, të cilët bëhen njëkohësisht edhe miqtë e tyre.

**MOS U MENDO SHUMË!
PRANOJE EDHE TI NDIHMËN!**
Mëso si të ndihmosh të tjerët që edhe ata të jenë të shëndetshëm, të lumtur dhe njëkohësisht edhe milionerë të suksesshëm. Siç do e thoshte edhe miku ynë më i mirë, Rex Maughan: "KUSHTOJI KËSAJ JETËN TËNDE!" Ndërkohë duhet të sundosh mbi ambiciet e tua. Duhet të besosh tek fati, por duhet të dish se **FATI NUK VJEN VETË, DUHET**

TË LUFTOSH PËR TË! Duhet të vendosësh! Në fillim vendosi vetes pikësynime të vogla, pastaj gjithmonë e më të mëdha! Mëso që duke besuar tek të tjerët, më shumë besoj tek vetvetja! Duhet të thuash Të Vërtetën edhe kur ajo të dhemb! Duaji të gjithë dhe mësoi që edhe ata t'i duan njerëzit! Respektoi njerëzit dhe mos i shfrytëzo ata! Mos i vendos interesat e tua në varësi të vendimeve të të tjerëve! Bashkëpunonjësit e tu të ardhshëm konsideroju si partner të barabartë! Tregohu konsekuent edhe kur të duket sikur ashtu nuk do të kesh sukses!

Vlerat e vërteta njerëzore nuk dallohen kur gjithçka është e bukur dhe e përkryer, por kur pavarësisht nga vështirësitë u qëndrojmë besnik ndjenjave, fjalëve dhe veprimeve tona. **KUR E ARRIN KËTË, MUND TË NISESH NË RRUGËN DREJT SUKSESIT!**

Të gjithë priten nga një rrugë që i çon drejt lumturisë, e cila s'është aspak e thjeshtë, por mund të përshkohet vetëm me vullnet dhe besim të fortë. **KËSHTU DO TË BËHET E THJESHTË DHE E PASTËR.**

Forca e punës në skuadër zgjon tek të gjithë vlerat që flenë brenda nesh. Kjo luftë nuk është e lehtë. Ndonjëherë mund të sundohesh nda ndjenja sikur të gjithë të lanë në baltë, të zhgënjyen, nuk të respektojnë, derdh gjak nga plagë të shumta, por koha dhe besimi në punë t'i shëron plagët. Duhet të besosh në forcat, ndershmërinë, dashurinë tënde, merr përsipër detyrimet e tua, tregohu konsekuent, dhe përpjekjet e tua do të kurorëzohen nga sukcesi. Po të tregoj se si mund ta arrish gjithë këtë:

- Produktet tona rrisin rezistencën e organizmit.
- Mos u përpiq t'i bindësh me çdo kusht të gjithë që të shpërndajnë produktet tona.
- Duhet t'ua thush të gjithëve që të mos presin mrekulli.
- Mos i shit njohuritë e tua, por përcillua të tjerëve.

- Mos premto parajsën tokësore, sepse rruga drejt suksesit kërkon shumë punë dhe mënjanim.
- Vetëm me punë të ndershme dhe sinqeritet mund t'i bindësh të interesuarit që të bëhen konsumatorë të produkteve dhe punonjës të kompanisë FLP.

Lufta dhe dashuria e madhe e investuar në punë së shpejti do të sjellë në jetën tuaj vlera të vërteta dhe ndryshime të mëdha, të cilat do të vihen re nga gjithë mjedisi juaj.

FLP-JA ËSHTË PAMJA E TË ARDHMES, MË BESO, ËSHTË NJË VENDIM I ZGJUAR TË HYSH NË RADHËT TONA!

Të tregohemi këmbëngulës dhe të guximshëm gjatë punës sonë, t'i vlerësojmë karakteristikat e mira të njerëzve të suksesshëm, t'i shmangim njerëzit e dështuar, dhe të ndjejmë përgjegjësinë e duhur për bashkëpunonjësit tanë të rinj e të vjetër gjithashtu.

Yjet e mi, bashkëpunonjësit e mi të dashur, ndjej forca dhe dashuri të mjaftueshme në vetvete për të gjithë ju dhe miqtë tuaj të ardhshëm. Ftojini ata në radhët tona dhe bëhuni tregues të mirë në rrugën e tyre drejt suksesit. Ju do të jeni Ylli im i Mëngjesit, do të shkëlqeni në qiell. Jeta juaj të karakterizohet nga bamirësia, ndihma e miqve dhe të njohurve, sepse kjo kontribuon që familja FLP nga dita në ditë të bëhet më e madhe dhe më e suksesshme.

Falenderoj gjithë anëtarët e skuadrës sime FLP dhe linjat e mia vëllazërore, sepse edhe kohën time të lirë e kaloj me kënaqësi me ta. Falenderoj gjithë punonjësit dhe drejtuesit e kompanisë FLP për ndihmën e tyre. Gjithë mysafirëve të pranishëm u uroj që puna juaj e drejtë dhe këmbëngulëse të kurorëzohet nga sukcesi në rrugën drejt nivelit diamant manager.

Faleminderit për vëmendjen tuaj. Ju dua shumë, **Cecilia** juaj!





CLEAN 9

Sipas studimit të zakoneve tona të blerjes çdo vit konsumojmë shtatëdhjetë kile sheqer dhe masatarisht 566 shishe me pije freskuese.

Kontrulli i përbërjes së produkteve është faktori më i rëndësishëm gjatë çdo blerjeje, pasi shumica e ushqimeve të paketuara paraprakisht përmban shumë lëndë shtesë dhe kimikale shpeshherë të rrezikshme, madje rrezikohemi edhe nga ndotja e përditshme e ajrit. Sipas jush ku shkon gjithë ky helm? Mendojeni mirë, organizmi jonë duhet të luftojë me to. Pra, s'ka dyshim se sa e rëndësishme është që çdo ditë të bëjmë diçka për shëndetin dhe mirëqenien tonë të përgjithshme.

Burimi: Forever Int. November 2006/Issue 68



Me programin tonë pastrues nëntë ditor mund të niseni në rrugën e jetesës së shëndetshme, sado me pengesa dhe e vështirë që dukej deri tani.

Është diçka e natyrshme që ta pastrojmë rregullisht organizmin tonë, por përse vetëm nga jashtë? Specialistët e ushqimit dhe të shëndetit janë prej një kohe të gjatë në një mendje që organizmi ynë duhet të pastrohet edhe nga brenda, duhet t'i largojmë rregullisht lëndët helmuese dhe mbeturinat që hyjnë brenda tij, pasi këto e dëmtojnë shumë shëndetin tonë. **Clean 9** gjatë një programi nëntë ditor e pastron organizmin tonë nga lëndët konservuese dhe lëndët e tjera kimike të dëmshme, ndërkohë që nis djegien e dhjamrave të tepërta të grumbulluara. Programi plotësues ushqimor dhe pastrues Forever Clean 9 përmban katër nga produktet tona: Xhel Aloe Vera, Forever Lite Ultra me shije çokollate ose vaniljeje,



Forever Bee Pollen, Forever Garcinia Plus. Këto produkte e mbështesin organizmin tonë me lëndët e tyre vepruese duke plotësuar njëra-tjetrën gjatë kurës nëntë ditore.

Është e rëndësishme të dimë se organizmi ynë e ka tepër të vështirë të absorbojë lëndët ushqyese me rëndësi jetike nga ushqimet dhe plotësuesit ushqimor të konsumuara nëse aparati tretës është plot me kimikalet e grumbulluara gjatë


viteve, të cilat hyjnë nëpërmjet lëndëve shtesë dhe ndotjeve të ndryshme. Me programin nëntë ditor mund të nisesh në rrugën e jetesës së shëndetshme, sado e vështirë që na dukej deri tani për t'u realizuar.

Organizmi i njeriut për ruajtjen e shëndetit ka nevojë për 22 aminoacide, ndërmjet të cilave tetë janë esenciale, këto mund të prodhohen nga organizmi. **Xheli Aloe Vera** i përmban të tetë aminoacidet esenciale, si dhe është i aftë t'i zbusë dhe t'i tresë ndotjet nga aparati i zorrëve, si dhe ndihmon në nxjerrjen e tyre nga organizmi. Xheli Aloe Vera përveç efektit të tij detoksikues luan rol edhe në normalizimin e tretjes dhe asimilimin efektiv të proteinave, ndërkohë që e ndihmon organizmin tonë të çlirohet edhe nga bakteret e dëmshme. Xheli Aloe Vera është një mjet i përsosur gjatë pastrimit të brendshëm të organizmit tonë.

Pijet plotësuese ushqimore **Forever Ultra Lite** me shije çokollate dhe vaniljeje janë mjete të domosdoshme të programit të suksesshëm pastrues dhe dobësues. Specialistë të shkencës ushqimore përcaktuan se me ndihmën e dietës me përmbajtje të lartë proteinash dhe të ulët karbohidrateve edhe Ju mund të bëheni i shëndetshëm dhe elegant. Forever Lite Ultra përmban 55% më shumë proteina dhe më pak se gjysma e karbohidrateve në krahasim me Forever Lite-n e zakonshme, madje falë përgatitjes moderne ka edhe shije të mirë. Me ndihmën e Forever Lite Ultra mund të jeni të sigurt që organizmi juaj merr çdo lëndë ushqyese të rëndësishme dhe të nevojshme, ndërsa lëndët shtesë dhe kimike të dëmshme mund t'i shmangni!

Forever Bee Pollen është një nga plotësuesit ushqimor më kompleks. Bee Pollen përmban gjithë spektrin e vitaminës B, si dhe vitaminën C. "Qendra për Shëndetin e Femrave" (Center for Women's Health Care)

na tërheq vëmendjen që edhe nëse e konsiderojmë të shëndetshëm ushqimin tonë, prapë mund të ndodhë që nga disa vitamina dhe lëndë minerale konsumojmë më pak se sa ka nevojë organizmi ynë.



Forever Bee Pollen përmban edhe beta-karotin, lëndë të ndryshme minerale, enzima, koenzima, karbohidrate, proteina dhe 22 aminoacide. Prandaj e konsiderojmë si element të domosdoshëm të programit Clean 9. Por Forever Bee Pollen nuk është i mirë vetëm si lëndë ushqyese, por edhe në metabolizmin e yndyrave, qarkullimin e gjakut, aparatit e tretjes, sistemin imunitar dhe sistemin nervor. Është mirë ta siguronit edhe pas përfundimit të programit nëntë ditor.

Frutin e Garcinia Cambogia-s e përdorin prej shekujsh në kuzhinë dhe si bimë mjekësore. **Forever Garcinia Plus** është anëtar i përkryer i programit Clean 9, pasi përmban shumë komponentë të cilët ndihmojnë organizmin në uljen e peshës. Komponenti i tij kryesor është acidi hydroxi-citrik (HCA). Burimi i HCA-s është lëkura e frutit. Analizat laboratorike vërtetojnë se HCA pengon depozitimin e karbohidrateve në formë dhjami duke penguar enzimën e këtyre proceseve. Nëpërmjet kësaj organizmi djeg dhjamin ekzistues, duke ndihmuar kështu akoma më shumë efektivitetin e dietës sonë me pak yndyra. Përveç këtyre Forever Garcinia Plus ul edhe oreksin, efekt i cili është tepër i dobishëm gjatë programit të kontrollit të peshës.

Me ndihmën e programit plotësues ushqimor dhe pastrues **Clean 9** bëheni aq aktiv dhe të gjallë sa që e ndjeni që po ecni në rrugën më të mirë. Hapi tjetër do të jetë programi Lifestyle 30, i cili e tregon veten nga dita në ditë si vazhdim i kontrollit intensiv të peshës dhe mjet mbrojtës i shëndetit. Me ndihmën e Lifestyle 30 mund të mësoni si ta ruani elegancën e fituar, ndërkohë që organizmi juaj do ta dijë për faleminderit që shëndetin dhe pastërtinë e përdorni si parim kryesor. Kush tjetër do të kujdesej kështu për Ju përveç vetes suaj? Urime për vendimin dhe iu përshëndesim në rrugën shëndetit dhe



SHPALLJE KONKURSI

Shpk. **Forever Living Products Hungari** shpall një konkurs shtypi me rastin e përvjetorit të dhjetë të kompanisë në Hungari. Në këtë konkurs mund të marrin pjesë të gjithë përfaqësuesit e medias elektronike dhe të shtypit, të cilët kanë dëshirë të përgatisin ndonjë shkrim, raport, artikull apo publikim rreth temave të dhëna në konkurs. Punimet e publikuara, kasetat e programeve të radios dhe televizorit, si dhe kopjet e tyre, ose ndoshta dvd-t apo kasetat e ndryshme të nxjerra gjatë periudhës së konkursit dërgojini në adresën e mëposhtme:
1067 Budapest, rr. Szondi 34. Në zarf shkruani: Ofertë shtypi FLP.

Konkursin e shpallim në dy tema:

1. Historia e bimës Aloe Vera dhe roli i saj në ruajtjen e shëndetit dhe krijimin e një mënyre më të shëndetshme jetese.
2. Multi level marketing si forma tregëtare më efektive e shekullit XXI, historia, përhapja e saj, mendimet e gabuara në lidhje me ndërtimin e biznesit.

Periudha e konkursit: nga 20 mars 2007 deri më 20 maj 2007.

Punimet vlerësohen nga specialistë me emër.

Shpallja e rezultatit: më 26 maj 2007, në Ditën e Suksesit të FLP-s në Arenën Sportive Laszlo Papp të Budapestit.

Shpërblimet: Tre vendet e para marrin shpërblime parash:

1. 200 000 Ft
2. 150 000 Ft
3. 100 000 Ft

U japim shpërblime me vlerë edhe autorëve të punimeve të shkëlqyera, si përshembull një fundjavë wellness në kështjellën e Szirak-it, bileta make-up, kozmetike dhe masazhi në qendrën kozmetike të FLP-s.

Juria ka të drejtë t'i përmbledh apo t'i mbajë shpërblimet në varësi të nivelit të konkursit. Presim sa më shumë punime, dhe pjesëmarrësve u urojmë punë të suksesshme.

Shtypi

Botuese: Kompania Forever Living Products, Hungari.

Redaktori: FLP Magyarországi Kft. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455

Redaktori kryesor: Dr. Milesz Sándor

Redaktor: Kismárton Valéria, Veress Angéla, Rókás Sándor

Fotografia e kopertinës: Bakos Veronika

Përgatitja për shtypje: Tipofill 2002 kft.

Grafika: Teszár Richárd, Buzássy Gábor

Shtypi: Veszprémi Nyomda Zrt. U përgatit në 49 250 kopje

Për përmbajtjen e artikujve shkruarit mbajnë përgjegjësi! Çdo e drejtë mbrohet!

Përkthyes, redaktues: shqip: Dr. Marsel Nallbani – kroat: Darinka Aničić, Anić Antić Žarko

– serb: Tóth-Kása Ottília, Molnár Balázs, Meseldžija Dragana – sloven: Novak Császár Jolanda, Biro 2000 Ljubljana



ABOVE & BEYOND

FOREVER LIVING PRODUCTS SUPER RALLY 2007 AUG 2-4



www.flpseeu.com

FOREVER



*I mirëpresim të gjithë
punonjësit tanë që
duan të mësojnë dhe
pushojnë*

Sonya
Color Collection

*në Qendrën
Mësimore dhe të
Shërbimit Sonya.*



Orari i hapjes në **Magazinën** tonë
(1183 Budapest, rr. Nefelejcs 9–11) **e hënë, e martë, e enjte:** 14:00–20:00,

në **Qendrën** tonë
(1067 Budapest, rr. Szondi 34, kati II) **e mërkurë, e premte:** 13:00– 17:00.

Punonjësit e qendrës së re, masazhatorët Ildiko Hrnicsjar dhe Csilla Fülöp
dhe specialistja e kozmetikës Ildiko Meszaros (06-20/457-1155).

Ata që duan të zbukurohen dhe të mësojnë në qendrën mësimore
priten vazhdimisht nga Kata Ungar!



Hotel Kastély Szirák
3044, Szirák, Petőfi út 26.

Tel.: (0036)32-485-300
e-mail: kastelyszirak@globonet.hu

FOREVER RESORTS

HOTEL KASTÉLY
SZIRÁK

Nga muaji maj, pas dorëzimit të qendrës Wellness mysafirët tanë që dëshirojnë të pushojnë i presim me më shumë shërbime. Sigurojmë një ambient të qetë dhe miqësor për organizmin e kurseve përgatitore të grupeve të distributorëve.





Sonya[®]
Color Collection